



BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 18-24 MUAJ
MUAJI JANAR



PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

<http://femijetetiranes.al/>

 Fëmijët e Tiranës

 femijet_e_tiranes

© **Spektori i Zhvillimit dhe Kujdesit Psiko-Social**

“Kuriozitete për Muajin Janar për t’u diskutuar me fëmijët”

- * **JANARI** është muaji i stinës së dimrit.
- * Në Janar bie dëborë dhe çdo flok dëbore ka 6 cepa.
- * Në Janar dielli duket më i madh.
- * Në Janar pemët nuk rriten.
- * Në Janar shumë kafshë bien në gjumë të gjatë.
- * Nata është më e gjatë se dita.



Muaji Janar– “Familja dhe profesionet”

Grupmosha: 18-24 muaj



- Java I: Familja, anëtarët dhe shtëpia jonë.
- Java II: Profesionet e dentistit, mjekut, policit, shitësit, zjarrfikësit.
- Java III: Profesionet e artit: Këngëtar, piktor, muzikant dhe balerin.
- Java IV: Profesionet e kuzhinierit, muratorit, parukierit dhe fermerit.


Tema mujore: “Familja dhe profesionet”

Temat Javore	Qëllimi	Koha e realizimit
Anëtarët e familjes:	Të njohim familjen dhe anëtarët e saj: mami, babi, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja.	Java I
Profesionete dentistit, mjekut, policit, shitësit, zjarrfikësit:	Të ndërtojmë aktivitete njohëse ku fëmijët nëpërmjet lojës të mësojnë profesionet.	Java II
Profesionet e artit:	Të njohim fëmijët me profesionet e artit duke i udhëzuar dhe nxitur të kryejnë aktivitete artistike.	Java III
Profesionete kuzhinierit, muratorit, parukierit, fermerit:	Të kryejmë aktivitete me punë dore dhe art ku fëmijët të kenë mundësi të zhvillojnë njohjen dhe motorikën.	Java IV

Tema mujore: “Familja dhe profesionet”

Tema e javës I: Familja, anëtarët dhe shtëpia jonë.



Java I	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Familja Ime. 	Aktivitet: Me fotot familjare, të siguruara paraprakisht nga prindërit, organizojmë një ekspozitë ose i varim fotot me fije spango. Më pas i kërkojmë fëmijëve me radhë të marrin foton ku ndodhen familjarët e tij/saj. Nëpërmjet këtij aktiviteti fëmijët arrijnë të identifikojnë familjarët dhe me anë të bisedës me edukatorët, gjatë aktivitetit, i'u kërkohet të gjejnë në foto pjesëtarët e familjes. Përralla: Kush e shëroi elefantushin.	<i>Foto familjare, fije spango ose peri, ngjitëse për fotot.</i> <i>Bashkëngjitur me programin gjeni përrallën.</i>
E Martë	Shtëpia ime	Aktivitet: Staf i përgatit format gjeometrike të prera më pare për të formuar shtëpinë. Më pas fëmijëve, të ndarë në grupe i'u jepen format, të cilat duhet t'i ngjisin në formatet A4. Puna organizohet në grup në mënyrën më të mire sesi edukatorët vetë mund të menaxhojnë grupin.	Kartona me ngjyra, fleta format A4, ngjitës vinovil.

		<p>Këngë: Shtëpia e Bubit. Lojë: Me kuba ndërtues</p>	
E Mërkurë	<p>Rolet në familje</p> 	<p>Luajmë me role: Me anë të mjeteve si pampers, veshje, biberon, gushore etj improvizojmë me fëmijët përkujdesjen për një bebe kukull. I lemë fëmijët ta bëjnë këtë rol dhe dëshmojmë imagjinatën e lirë të secilit. Improvizim i punës në familje: Me anë të materialeve kryesisht plastike improvizojmë së bashku shtrimin e tavolinës. <i>Shënim: Aktivitetet synojnë të njohin fëmijën me rolin kryesor në familje që është përkujdesja. Mund të zgjidhni sipas mundësive vetëm 1 aktivitet.</i></p>	<p><i>Kukull, pampers, biberon, gushore, mjete të higjenes.</i></p> <p><i>Mbulesa, pjata, gota, lugë plastike.</i></p>
E Enjte	<p>Aktivitet: art dhe krijime për familjen.</p> 	<p>Krijim: Me anë të mjeteve të riciklueshme së bashku me ndihmën e edukatoreve bëjmë një aktivitet me në fokus familjen. Me anë të mjeteve didaktike krijojmë korniza ku mund të vendosim fotot familjare të cilat më pas ja japim fëmijëve me vete në shtëpi. Aktiviteti mund të përfshijë edhe ngjyrosjen me bojëra.</p> <p>Përrallë: Genti bën gol.</p>	<p><i>Mjete të riciklueshme, kartona, bojëra, fleta me ngjyra.</i></p> <p><i>Bashkëngjitur me programin gjeni përrallën.</i></p>
E Premte	Gjyshërit	<p>Punë dore: Përagtisim kartolina për gjyshërit me frazën: <i>(Gjysh, gjyshe, të falënderoj që u shqetësove për mua, që u sigurove që kur jam me ty të kem gjithmonë një buzëqeshje në fytyrë.)</i></p>	<i>Mjete punë dore.</i>







Lojë energjike me karrige.


Tema mujore: “Familja dhe profesionet”

Tema e javës: Profesionet e dentistit, mjekut, policit, shitësit, zjarrfikësit.



Java II	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Profesioni i dentistit 	<p>Aktivitet: Fëmijët në drejtimin e edukatoreve kryejnë procesin e larjes së dhëmbëve. Gjatë lojës edukatorja i tregon fëmijëve kur duhet të shkojmë te dentist dhe kujdesin që duhet të tregojmë ndaj ëmbëlsirave.</p> <p>Përallë: Era shkon tek dentisti.</p>	<p><i>Mjete të higjenës së gojës të siguruara më parë nga prindërit.</i></p> <p><i>Përallën e gjeni bashkëngjitur programit.</i></p>
E Martë	Profesioni i mjekut	<p>Aktivitet: Edukatorja improvizon vizitën e një kukulle tek mjeku. Fëmijët luajnë në mënyrë imagjinare duke vizituar kukullat sikur ata të jenë mjekët.</p>	<p><i>Kukulla, çanta e doktorit.</i></p> <p><i>Bashkëngjitur me programin gjeni</i></p>



		Këngë lëvizore: “Nëse ti je i lumtur”	<i>këngën.</i>
E Mërkurë	Profesioni i policit 	Aktivitet: Në grup improvizohet situata e një polici i cili ndihmon fëmijët të kalojnë rrugën. Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin uniformën e policit.	<i>Unifoma e policit, bilbili, shirita të bardhë etj. Format i printuar A4, ngjyra.</i>
E Enjte	Profesioni i shitësit 	Aktivitet: “Marketi i lodrave”. Fëmijët e ndarë në grupe improvizojnë në “marketin” e krijuar në çerdhe rolin e shitësit dhe të blerësit. Me ndihmën e edukatoreve ata mësojnë si ndërveprohet në të dyja rolet. Kërcejmë: Këngë për fëmijë	<i>Stendë, kuti organizimi për lodra.</i>
E Premte	Profesioni i zjarrfikësit.	Aktivitet ngjyrosje: Ngjyrosim makinën e zjarrfikëses dhe uniformën e zjarrfikësit. Gjatë kohës bisedojmë me fëmijën për detajet: ngjyra e makinës së zjarrfikëses, zhurma që bën etj. Lojë: “Tuneli”	<i>Fleta A4, ngjyra, hula hoop ose kartona. Me anë të rrashëve (hula hoop) ose</i>



			kartonave krijojmë një tunel dhe ftojmë fëmijët të kalojnë me radhë. (E demonstruar me foto)
--	---	--	--

Tema mujore: “Familja dhe profesionet”

Tema e javës III: Profesionet e artit (Këngëtar, piktor, muzikant, balerin)



Java III	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Profesioni I këngëtarit 	Aktivitet: Fëmijët këndojnë me mikrofon këngë të ndryshme të mësuara në çerdhe. Përrallë: “Shfaqja e dinosaurve”	<i>Mikrofon. Përralla bashkëngjitur programit .</i>
E Martë	Profesioni i piktorit. 	Aktivitet: Fëmijët ngjyrosin të lirë me mjete si: penele, telajo, fleta, bojëra. Sugjerohet që fëmijët të jenë të lirë në krijimtarinë e tyre. Lojë energjike: Me birila	<i>Penela, bojëra, telajo, fleta, birila.</i>



E Mërkurë	Profesioni i muzikantit. 	Improvizim: Me vegla muzikore të ndryshme të sjella nga prindërit ose që disponojnë nëçerdhe fëmijët ndërtojnë orkestrën duke luajtur në vegla muzikore të ndryshme. Gjatë aktivitetit edukatoret kërcejnë me fëmijët.	<i>Vegla të ndryshme muzikore.</i>
E Enjte	Profesioni i balerinit 	Aktivitet: Fëmijët të drejtuar nga edukatoret kryejnë lëvizje të balerinëve dhe kërcejnë në grup. Ngjyrosje: Formojmë figurën e balerinëve me mjete didaktike si në udhëzim.	Mjetedidaktike, objekte të riciklueshme.
E Premte	Aktivitet Artisitik në Grup	Aktivitet: “ Muzikantët e vegjël” . Dita e festës në grup në çerdhe ku të gjithë fëmijët këndojnë, luajnë me mjete muzikore dhe kërcejnë sëbashku.	<i>Mjete muzikore. Improvizim shfaqje.</i>

Tema mujore: “Familja dhe profesionet”

Tema e javës IV: Profesionet e Kuzhinierit, muratorit, parukierit dhe fermerit.



Java IV	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p>Profesioni i kuzhinierit</p>	<p>Aktivitet: Në grup kuzhinierja e çerdhes iu tregon fëmijëve mjetet që përdor në kuzhinë duke ia emërtuar ato.</p> <p>Punë dore: Fëmijët formojnë me brumë topa të vegjël.</p>	<p><i>Mjetet e kuzhinës: tenxhere, garuzhde, lugë etj. Brumë</i></p>
E Martë	<p>Profesioni i Muratorit</p>	<p>Aktivitet: Me anë të mjeteve të riciklueshme si psh: kuti këpucësh kartoni të vogla, karton etj, fëmijët ndërtojnë “shtëpinë e tyre” duke vendosur blloqet me kartona të udhëzuar nga edukatorët. Edukatorja instruktton procesin.</p> <p>Kënga: “Shtëpia e Bubit”</p>	<p><i>Kuti Kartoni.</i></p>

<p>E Mërkurë</p>	<p>Profesioni i parukierit</p> 	<p>Aktivitet : Fëmijët me ndihmën e edukatoreve, të cilat kanë përgatitur më parë një pjesë të materialeve, vendosen të kryejnë aktivitetet si në figurat e udhëzuara në program. Fëmijët presin me gërshërë dhe lyejnë me bojëra.</p>	<p><i>Bashkëngjitur programit gjeni udhëzimet me figura.</i></p>
<p>E Enjte</p>	<p>Profesioni i fermerit.</p> 	<p>Aktivitet: “Mjelim Lopën”. Duke ndjekur udhëzimet bashkëngjitur programit, edukatoret udhëzojnë fëmijët sesi të kryejnë procesin e mjeljes së lopës. Ata bisedojnë me fëmijët për këtë dhe shumë punë të tjera të fermës.</p> <p>Këngë & Kërcim: “Plaku Donald ka një fermë”</p>	<p><i>Doreza të bardha plastike, ngjitës, karton, lidhëse, tas.</i></p>
<p>E Premte</p>	<p>Aktivitet i lirë.</p>	<p>Nëse koha është e përshtatshme fëmijët i nxjerrim në oborr të luajnë.</p>	